Arrestohet një serb i dyshuar për krime lufte në Kosovë

21 qershor 2023, 14:54

Shpërndaje në

Policia e Kosovës në bashkëpunim me Prokurorinë ka njoftuar të mërkurën për arrestimin e një shtetasi serb D.M., i cili dyshohet për krime lufte në Kosovë.

D.M. dyshohet se ka kryer krime lufte gjatë periudhës 1998-1999 në cilësinë e gardianit të burgut.

"Ndaj të njëjtit janë siguruar prova për ekzistimin e dyshimit të arsyeshëm se në bashkëkryerje edhe me pjesëtarë të tjerë, gjatë periudhës së luftës në Kosovë në cilësi të personave zyrtar (gardian të burgut) në Prishtinë dhe në paralelen e ndarë nga Prishtina konkretisht në burgun e Lipjanit, në mënyrë sistematike, dyshohet se kanë ushtruar torturë, dhunë fizike, psikike, keqtrajtime dhe maltretime çnjerëzore dhe të skajshme për jetën ndaj të burgosurve shqiptarë", thuhet në njoftimin e Policisë.

Policia e Kosovës e arrestoi të dyshuarin në zonën e Graçanicës.

Sipas njoftimit, gjatë kontrollit në shtëpinë e tij, i është konfiskuar një armë zjarri-revole e tipit "Zastava" cal.9mm, 136 fishekë të kalibrit 9x19mm, thikë ushtarake e tipit SOG Speciality Knives, shufër metalike "Taiwan" dhe dokumente, vendime, notes dhe telefon personal, etj.

I dyshuari është intervistuar në prezencë të avokatit mbrojtës të siguruar nga familja, nën dyshimin se i njëjti është përfshirë në veprën penale "krime lufte kundër popullsisë civile".

© KOHA. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Klikoni këtu nëse dëshironi t'i lexoni lajmet e fundit dhe të përzgjedhura në kanalin tonë zyrtar në Viber

Gjendet pa shenja jete një 56-vjeçare në Mitrovicë
Gjendet pa shenja jete një burrë në Viti
Vrasje në tentativë në Prishtinë

Dyshohet se ngacmonte e pëcillte një vajzë, arrestohet burri nga Prishtina
Ra nga platoja e objektit ku punonte, punëtori në gjendje të rëndë dërgohet në QKUK
Plagoset një person në një nga diskotekat e Prishtinës
Një muaj paraburgim për Urosh Vukasinovicin, i dyshuar për sulm ndaj gazetarëve

Taboola Feed

Ja si mund të mbani në kontroll mykun e këmbëve në kushte shtëpie
Blog | Sponsored
Lexo më shumë

Qetësoni dhimbjen e kockave dhe të muskujve në kushte shtëpie
Blog | Sponsored
Lexo më shumë

I vodhi portofolin një gruaje, shtetasja e huaj arrestohet në Pejë
Një shtetase e huaj është arrestuar në Pejë nën dyshimin se të enjten e kaluar i ka vjedhur portofolin një gruaje. Policia ka njoftuar të martën se në portofolin e vjedhur ka pasur disa …
Kohanet

Ja disa këshilla në lidhje me dhimbjen e kockave
Blog | Sponsored
Lexo më shumë

How Much Do Fertility Treatments Cost, Anyway?
IVF | Search Ads | Sponsored



The Prices Of A Masters Degree in Germany Might Actually Surprise…
Study in Germany | Search | Sponsored

Policia kërkon ndihmë për identifikimin e dy të dyshuarve për përfshirje në një vjedhje
Policia e Kosovës kë kërkuar bashkëpunim nga qytetarët për identifikim të dy personave të dyshuar për përfshirje në një vjedhje. Njësiti i hetimeve të stacionit policor Qendra në …
Kohanet

Albania: The Cost of Cyprus Investments Might Surprise You
Cyprus Investments | Search Ads | Sponsored

TË TJERA

Policia kërkon ndihmë për identifikimin e dy të dyshuarve për përfshirje në një vjedhje

Gjakovari i kërkon gruas të largohet nga banesa, i konfiskohet një armë e lirohet në procedurë të regullt

Tetë persona përfshihen në një rrahje në Obiliq, përdoren edhe armë zjarri

Shtatë të arrestuar, dyshohen se përdorën Kosovën si transit për kontrabandimin e emigrantëve

Kjo faqe kontrollohet dhe menaxhohet nga KOHA. Të gjitha materialet në të, përfshirë fotografitë, janë të mbrojtura me copyright të KOHA-s dhe për to KOHA mban të drejtat e rezervuara. Materialet në këtë faqe nuk mund të përdoren për qëllime komerciale. Ndalohet kopjimi, riprodhimi, publikimi i paautorizuar qoftë origjinal apo i modifikuar në çfardo mënyre, pa lejen paraprake të KOHA-s. Shfrytëzimi i materialeve nga ndonjë faqe interneti a medium tjetër pa lejen e Grupit KOHA, në emër të krejt njësive që e përbëjnë (Koha Ditore, KohaVision, Koha.net, Botimet KOHA, KOHA Print dhe ARTA), është shkelje e drejtave të autorit dhe të pronës intelektuale sipas dispozitave ligjore në fuqi. Të gjithë shkelësit e këtyre të drejtave do të ballafaqohen me ligjin.

Përkthimi i përmbajtjeve në gjuhët tjera bëhet në mënyrë automatike dhe mund të ketë gabime!